

VENDIM
Nr. 607, datë 31.8.2016

PËR KRIJIMIN, PËRBËRJEN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
AGJENCISË KOMBËTARE TË KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
(AKKSHI)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të neneve 12 e 13, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) si një institucion publik, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

2. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është institucion buxhetor, që financohet me fonde të buxhetit të shtetit dhe fonde nga programet dhe projektet e BE-së, të shteteve të veçanta dhe të organizatave partnere, donacione të subjekteve fizike dhe juridike, vendase dhe të huaja, si dhe çdo financim tjetër të ligjshëm.

3. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për mision të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin, nëpërmjet mbështetjes, monitorimit e vlerësimit të programeve dhe projekteve në fushën e shkencës, teknologjisë dhe inovacionit (SHIT), si dhe administrimin e përditësimit e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor dhe inovacionin.

4. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për detyrë:

a) identifikimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, që miratohen nga ministri i Arsimit dhe Sportit;

b) shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë kërkimin shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane;

c) organizimin, çdo katër vjet, sipas metodologjisë së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, të procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njëjësive bazë, të institucioneve të arsimit të lartë, duke i renditur ato në bazë të këtij vlerësimi;

ç) miratimin, mbi bazën e konkurrencës së lirë ndërmjet aplikantëve, të fondeve për projektet e studimeve të doktoratës;

d) administrimin dhe përditësimit e bazës kombëtare të të dhënave për kërkimin shkencor në sistemin e arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të nenit 13, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe kuadrit ligjor në fuqi për administrimin e bazave elektronike të të dhënave;

dh) administrimin dhe bërjen publike të bazës të të dhënave, me të gjitha projektet e financuara prej saj, në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkim-zhvillimit;

e) dhënien e informacioneve, rekomandimeve e sugjerimeve Ministrisë së Arsimit e Sportit dhe institucioneve të tjera, lidhur me aspektet e politikave dhe strategjive sektoriale në fushën e kërkimit shkencor e inovacionit.

5. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, ka përgjegjësi për:

a) shpërndarjen e informacionit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor, për institucionet e arsimit të lartë, qendrat dhe institutet kërkimore-shkencore në vend;

b) koordinimin e Rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit të Programit të BE-së për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin;

c) komunikimin e vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe renditjen e njëjësive kryesore

e bazë të institucioneve të arsimit të lartë, për Agjencinë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

ç) administrimin e fondeve të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit, në kuadrin e programeve kombëtare, ndërkombëtare të kërkimit shkencor, të cilat i shpërndan bazuar në aplikimet e subjekteve publike e jopublike, që kanë në statusin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor;

d) paraqitjen, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të raportit vjetor të veprimtarisë së saj, pasi e ka miratuar paraprakisht në bordin e administrimit;

dh) bashkëpunimin me ministritë dhe institucionet e tjera për zbatimin e strategjisë kombëtare sektoriale në fushën e shkencës dhe inovacionit;

e) nxitjen e bashkëpunimit me sektorin e biznesit në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë e inovacionit dhe mbështetjen ndaj iniciativave të tij, në këtë fushë.

6. Për nevoja të realizimit të veprimtarisë së saj, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit shkëmben informacion me:

a) institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

b) institucionet e arsimit të lartë, qendra dhe institucione kërkimore-shkencore në vend;

c) institucione të tjera publike dhe jopublike, që lidhen me fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionin.

7. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit organizohet dhe funksionon nëpërmjet organeve dhe autoriteteve drejtuese të saj, të cilat janë bordi i administrimit dhe drejtori i Përgjithshëm.

8. Bordi i administrimit është organ kolegjal vendimmarrës, që kryesohet nga ministri i Arsimit dhe Sportit dhe ka në përbërje:

a) ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike;

b) dy përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

c) drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

ç) drejtorin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;

d) përfaqësues nga Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë;

dh) përfaqësues nga Konferenca e Rektorëve;

e) përfaqësues nga Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë.

9. Funksionet e bordit të administrimit janë:

a) Miraton, përpara miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit që do të financohen;

b) Miraton përbërjen e komisioneve të ekspertëve të vlerësimit të programeve dhe projekteve, sipas fushave të shkencës;

c) Miraton aktet e brendshme të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

ç) Propozon në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit buxhetin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

d) Miraton financimin e projekteve në fushën e kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit dhe projektet e studimeve të doktoratës, bazuar në:

i) fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të miratuara nga Ministria e Arsimit e Sportit;

ii) grantin e punës kërkimore-shkencore;

iii) vlerësimin e komisioneve të ekspertëve të programeve dhe projekteve.

dh) Miraton rezultatet e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njëjësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë përpara se këto rezultate dhe renditja përfundimtare t'i komunikohet Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë;

e) Miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit brenda katërmujorit të parë të vitit pasardhës, i cili bëhet publik.

10. Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inova-cionit

funksionon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", dhe rregullores së tij të brendshme, të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Sportit.

11. Kryetari dhe anëtarët e bordit të administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen nga buxheti i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.

12. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit është titullari i institucionit dhe përfaqëson agjencinë në marrëdhënie me të tretë. Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

a) Drejton, koordinon dhe monitoron veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

b) Paraqet në Bordin e Administrimit, për miratim, aktet e brendshme që lidhen me veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

c) Nënshkruan kontratat e financimit me aplikantët fitues, në kuadër të thirrjeve të hapura që realizohen nga agjencia;

ç) Bashkëpunon me agjencitë homologe në vende të tjera, nëpërmjet vendosjes së kontakteve, nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit për shkëmbim të eksperiencave dypalëshe;

d) Informon Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe bordin e administrimit për veprimtarinë e agjencisë, sa herë i kërkohet;

dh) Harton dhe paraqet, brenda afatit të parashikuar në bordin e administrimit, raportin vjetor për veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit;

e) Siguron pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve të financimit të kërkimit shkencor;

ë) Siguron pjesëmarrjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor e Inovacionit në projekte të ndryshme ndërkombëtare.

13. Drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar.

14. Struktura dhe organika e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

15. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

16. Numri i punonjësve të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) i kalon AKKSHI-it. Për nëpunësit civilë të AKTI-t zbatohen dispozitat e legjislacionit për nëpunësin civil në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

17. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, për çështjet e përmbajtjes dhe të vlerësimit të projekteve, kontraktin ekspertë vendas e të huaj si pjesë e komisioneve të vlerësimit.

18. Programet dhe projektet në administrim të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI) transferohen me të gjitha të drejtat dhe detyrimet pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

19. Të gjitha komisionet e ekspertëve të vlerësimit, të Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, që kanë qenë përzgjedhur për vlerësimin e projekteve kombëtare të kërkim-zhvillimit dhe projekteve të bashkëpunimit shkencor dypalësh, qëndrojnë në detyrë deri në përzgjedhjen e ekspertëve të komisioneve të reja të vlerësimit. Raportet e vlerësimit që ata kanë hartuar gjatë kësaj periudhe, për vlerësimin e projekt-propozimeve të ndryshme, të paraqitura pranë Agjencisë së Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, mbeten në fuqi dhe shërbejnë si bazë për financimin e projekteve të përzgjedhura nga Agjencia Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe

Inovacionit.

20. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 1.7.2016 dhe përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

21. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama